



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:261117
Datë: 20.05.2024
Numri i dokumentit: 05706304

A.C.nr.1022/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Bujar Muzaqi, Kryetar, Enes Mehmeti dhe Hysni Bardheci, anëtarë, në çështjen kontestimore të paditëses Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me seli në Komuna Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore e Republikës së Kosovës, me autorizim avokati shtetëror Naim Krasniqi, kundër të paditurit M.N. nga fshati ..., Komuna Pejë, në çështjen kontestimore për kompensimin e dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit, të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1386/19 datë 21.12.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurit M.N. nga fshati ..., Komuna Pejë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1386/19 datë 21.12.2020, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1386/19 datë 21.12.2020, ndër të tjera ka vendosur si vijon:

“... I. APROVOHET në tersi si e bazuar kërkesë padia e paditëses Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ashtu që DETYROHET i padituri M.N. nga fsh. ... Komuna Pejë, në emër të dëmit të shkaktuar t’ia paguajnë shumën prej 1,431.00 euro,

në llogarinë e paditësit MMPH nr. 1000400070002120, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale...”.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë i padituri, për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurit dhe të anulohet aktgjykimit dhe lënda të kthehet në shkallën e parë në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, e ekzaminojë aktgjykimin e shkallës së parë në bazë të nenit 194 lidhur me nenin 208, të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore dhe gjeti se:

-Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësja Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me seli në Komuna Prishtinë, ka paraqitur padi me datë 11.11.2019, kundër të paditurit M.N. nga fshati ..., Komuna Pejë, për kompensimin e dëmit.

Gjykata e shkallës së parë, pas mbajtjes së seancës kryesore, dëgjimit të palëve në procedurë, dhe administrimit të provave, ka marrë aktgjykim C.nr.1386/19 datë 21.12.2020, me të cilin aktgjykim e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, Gjykata e shkallës së parë ndër të tjera ka arsyetuar se: *“...gjykata vendosi duke u bazuar në Çmimorën për kompensimin e dëmeve e cila është nxjerrë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me numër 01/2015, e datës 18.03.2015, ku i padituri për 4 m³, masë drunorë të prerë të llojit të breut obligohet që në emër të kompensimin të dëmit material ti paguaj paditëses shumën prej 1,431.00 euro...”.*

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykim i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e Apelit duke marrë parasysh të gjitha provat e administruara në këtë çështje juridike dhe atë se i padituri i ka shkaktuar dëm material drejtorisë për administrimin e parkut kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" kjo vërtetohet edhe me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Pejë, me numër P.nr. 1051/17 i datës 22.01.2018, ku theksohet se i padituri me datë 18.06.2016, rreth orës 15:45 minuta, në Fshatin ..., K. Pejë në vendin e quajtur "Te Brezat" me qëllim të vjedhjes ka bërë prerjen e 15 trungjeve të llojit të Breut, me gjatësi 4 m, në atë mënyrë që gjersa i pandehuri po transportonte trupat me kamionin e tij të tipit xxx, me ngjyrë të xxx, pa targa, ku arrin në rrugën "Nëna Terezë" ndalohej nga ana e Policisë së Kosovës, e pasi drunjtë ishin të pa damkosura, dhe pa leje përkatëse, të njëjtat janë konfiskuar nga ana e policisë, me çka ka kryer veprën penale të vjedhje pylli e mbetur në tentativë nga neni 358 par. 1e lidhur me nenin 28 të KPRK-së, ku këtu i padituri ka pranuar fajësinë dhe të njëjtit i është shqiptuar dënimi me gjobë në lartësi prej 200 euro, nga kjo rrjedhë edhe e drejta e paditëses dhe detyrimi i të paditurit për kompensimin e dëmit të shkaktuar me rastin e dëmtimit të pyllit.

Ndërsa në nenin 136 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve në mënyrë decidive thuhet se *"Kush i shkaktonte dëmin ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij"*.

Po ashtu edhe me aktgjykimin P.nr.1051/17 datë 22.01.2018, të marrë nga Gjykata Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, i cili aktgjykim është bërë i plotfuqishëm me datë 22.03.2018, i padituri M.N., është shpallur fajtor për vjedhjen e pyllit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve, dhe në pajtim me dispozitat e nenit 450, të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore.

Pretendimi ankimor se gjykata e shkallës së parë është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, nuk qëndronë pasi që dispozitivi i Aktgjykimit është i kuptueshëm, i kjoartë dhe arsyetimi i Aktgjykimit përmban të gjitha faktet vendimtare, dhe arsyet pse është vendosë si në dispozitiv të Aktgjykimit.

Gjykata e Apelit vlerëson se sa i përket pretendimit ankimor të palës ankuese se kemi të bëjmë me aplikim të gabuar të drejtës materiale nuk ka ndonjë pretendim konkret në të cilën është thirrur pala ankuese në ankesë, ndërsa nuk ka shkelje për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore të të paditurit, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Numri i lëndës: 2019:261117
Datë: 20.05.2024
Numri i dokumentit: 05706304

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 195.1 pika d), e lidhur me nenin 200 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
A.C.nr.1022/2021 datë 20.05.2024

**Kryetari i kolegjit - Gjyqtari,
Bujar Muzaqi**